



Organizata “Përtej Barrierave”

Thirrje për Pozicion të Hapur Koordinator Projekti (part-time)

Termet e Referencës

Përtej Barrierave është një organizatë jofitimprurëse e shoqërisë civile, e themeluar në vitin 2004. Ne punojmë me të rinjtë në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian, duke promovuar përfshirjen dhe ngritjen e kapaciteteve përmes edukimit joformal. Përtej Barrierave është Pika e Kontaktit e programeve Erasmus+ YiA dhe European Solidarity Corps të Komisionit Evropian, për Shqipërinë.

Përshkrimi i punës

Koordinatori i Projektit është një pozicion pjesë e stafit të brendshëm të Organizatës. Fokusi kryesor i punës së koordinatorit qëndron në sigurimin e efektivitetit në menaxhimin e projekteve duke ofruar rezultatet e duhura teknike, operative, financiare dhe administrative gjatë ndjekjes së zhvillimit të projektit përmes monitorimit, vlerësimit dhe raportimit gjatë çdo faze të tij.

Koordinatori i Projektit do të punojë nën drejtimin e Menaxherit të Programit dhe do të jetë përgjegjës për implementimin e aktiviteteve të projektit që koordinon.

Në këtë kuadër, ai siguron që rezultatet të dorëzohen në përputhje me udhëzimet përkatëse, marrëveshjet dhe kontratat duke arritur menaxhimin dhe koordinimin e përgjithshëm të punës me qëllim dorëzimin në kohë të rezultateve të projektit.

Stafi i “Përtej Barrierave” do të mbështesë personin e përzgjedhur përgjatë punës së tij pranë apo jashtë zyrave të organizatës. Çdo detyrë e kryer nga Koordinatori duhet të jetë në përputhje me rregullat dhe procedurat e “Përtej Barrierave”, si dhe kërkesat e donatorëve.

Fusha e veprimit

Koordinatori i projektit do të angazhohet përkatësisht në tre drejtime përgjatë punës në organizatë:

1) Sera në Shkollën Speciale “Luigj Gurakuqi”

Përgjatë vitit të kaluar, “Përtej Barrierave” ndërtoi një serë për fëmijët e Shkollës Speciale “Luigj Gurakuqi” në Tiranë në të cilën mësojnë 127 fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara intelektuale të moshës 6-18 vjeç. Qëllimi kryesor i nismës ishte krijimi i një mjedisi mësimor miqësor për fëmijët dhe të rinjtë me aftësi të kufizuara intelektuale, të cilët, nëpërmjet kultivimit të bimëve, do të mund ndihmojnë të ndërtojnë aftësi praktike për jetën e tyre dhe tregun e punës.



Në këtë kuadër, puna e koordinatorit në serë do të fokusohet tek mbështetja dhe fuqizimi i fëmijëve dhe të rinjve me aftësi të kufizuara intelektuale për të përmirësuar mirëqenien e tyre mendore dhe fizike duke zhvilluar tek ata shpirtin e përfshirjes dhe vullnetarizmit.

2) *European Solidarity Corps*

European Solidarity Corps është një program i financuar nga Komisioni Evropian që krijon mundësi për të rinjtë që të angazhohen si vullnetarë, të punojnë, të trajnohen dhe të drejtojnë projektet e tyre të solidaritetit nga të cilat përfitojnë komunitetet në mbarë Evropën, përfshirë dhe Shqipërinë.

“Përtej Barrierave” ka pritur një numër të madh vullnetarësh nga Europa të cilët janë vullnetarizuar në Shqipëri me anë të angazhimit në organizatë nëpërmjet projekteve dhe aktiviteteve që ne ofrojmë.

Koordinatori i Projektit do të punojë ngushtë me Koordinatorin e Vullnetarëve në mënyrë që të ketë një menaxhim efektiv të vullnetarëve duke i angazhuar në aktivitete të projekteve të ndryshme, punës organizative dhe punës në serë.

3) *Projekte të tjera*

Pas 18 vitesh punë, “Përtej Barrierave” ka grumbulluar një përvojë të madhe në punën me të rinjtë në nivel lokal, kombëtar, rajonal dhe evropian. Me kalimin e viteve target grupi i shoqatës është zgjeruar për t'u dhënë hapësirë të gjithë të rinjve nga Shqipëria që të jenë pjesë e programeve dhe projekteve të saj. Gjithsesi fokusi kryesor i punës së shoqatës mbetet te të rinjtë me mundësi të pakta, për të qenë qytetarë aktivë të komunitetit ku jetojnë.

Organizata punon vazhdimisht me projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm, lokalë apo ndërkombëtarë sipas programeve të zhvillimit strategjik të saj. Në këtë kuadër, në mënyrë të vazhdueshme, Koordinatori do të menaxhojë projekte që përputhen me tematikat e mëposhtme:

- Edukimi për të Drejtat e Njeriut
- Puna Rinore
- Përfshirja dhe Diversiteti
- Qytetaria Aktive dhe Ndërtimi i Demokracisë
- Vullnetarizmi
- Sipërmarrja dhe Punësimi
- Dixhitalizimi dhe Inovacioni



Detyrat dhe pergjegjesite:

- Zhvillon, organizon dhe menaxhon zbatimin e projektit në konsultim të ngushtë me Menaxherin e Programit dhe pjesën tjetër të stafit;
- Menaxhon dhe koordinon zbatimin e aktiviteteve bazuar në dokumentet përkatëse të projektit, duke përfshirë, sipas nevojës, mbikëqyrjen dhe udhëzimet e stafit apo/dhe ekspertëve me synimin për të arritur rezultatet e projektit;
- Përgatit dhe siguron përgatitjen dhe dorëzimin në kohë të raporteve dhe dokumenteve të kërkuara të projektit;
- Monitoron cilësinë e zbatimit të projektit gjatë gjithë zbatimit në mënyrë që të ruhen standardet e pritura.
- Organizon, fton dhe merr pjesë në takime dhe aktivitete me aktorë të jashtëm në mënyrë që të sigurohet që të gjithë partnerët dhe përfituesit të informohen;
- Bashkëpunon me stafin e “Përtej Barrierave” në detyra organizative dhe administrative
- Kryen detyra të tjera që lidhen me punën e organizatës sipas kërkesës

Kriteret për aplikim

- Diplomë Bachelor në Punë Sociale, Administrim dhe Politika Sociale, Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Studime Europiane dhe fusha të tjera të lidhura;
- Së paku 3 vite eksperiencë në çështje dhe projekte që përfshijnë rininë;
- Eksperiencë në sektorin e shoqërisë civile;
- Njohuri shumë të mira të Gjuhës Angleze;
- Aftësi shumë të mira organizative;
- Aftësi shumë të mira në menaxhimin e kohës dhe prioritizimin e punës;

Dokumentet e nevojshme për aplikim

- Jetëshkrim (CV)
- Leter Motivimi

Fazat e Aplikimit

- 1) Dërgimi i dokumenteve të kërkuara
- 2) Zhvillimi i intervistës
- 3) Përzgjedhja



Subjektet e interesuara duhet të dërgojnë çdo aplikim brenda datës 5 Mars 2023, në adresën elektronike: office@beyondbarriers.org dhe cc silvia.dervishi@beyondbarriers.org